

مختصر شرح ألفاظ الأذان (للجمعية)

**SHPJEGIM I SHKURTËR I
FJALËVE TË EZANIT**

SHPJEGIM I SHKURTËR I FJALËVE TË EZANIT

Komisioni Shkencor pranë Shoqatës për Shërbimin e Mesazhit Islam në Gjuhë të Ndryshme

SHPJEGIMI I FJALËVE TË EZANIT

Komisioni Shkencor pranë Shoqatës për Shërbimin e Mesazhit Islam në Gjuhë të Ndryshme

Ezani është një thirrje hyjnore që muslimani e dëgjon pesë herë në ditë, i cili i kujton atij madhësitë e Allahut dhe e fton drejt së mirës dhe shpëtimit. Ai është një çast komunikimi ndërmjet njeriut dhe Krijuesit të tij, duke u shkëputur nga zhurma e kësaj bote për të qëndruar para Zotit të tij në lutje e përgjerim.

Ezani mbart mesazhe të larta që fillojnë me madhërimin e Allahut dhe përfundojnë me thirrjen për në namaz, ku muslimani gjen prehje dhe qetësi.

Fjalët e ezanit:

Allahu ekber, Allahu ekber

Allahu ekber, Allahu ekber

Allahu është më i Madhi

Emri i lartmadhërisëm “Allah”, do të thotë “i adhuruari”, dhe është emri i Zotit, Krijuesit të Lartmadhëruar. Të gjithë emrat e tjerë hyjnorë janë përshkrues e shpjegues të tij. Allahu është Një dhe i Vetmi, i Cili nuk ka lindur kënd e as nuk është i lindur prej kujt. Ai është Krijuesi i qiejve dhe i Tokës.

Fjala "Allahu ekber" do të thotë se Allahu është më i madh se çdo gjë që ekziston, dhe se Ai është më lart se çdo gjë që mund t'i përshkruhet Atij, që nuk i kanë hije madhësisë dhe përsosurisë së Tij.

"Allahu ekber.." Kjo frazë ia kujton muslimanit faktin se asgjë në këtë jetë nuk duhet ta shpërqendrojë nga Krijuesi i tij, dhe se njeriut i takon të ecë në këtë jetë sipas vullnetit të Allahut dhe ligjeve të Tij, e jo sipas tekave dhe dëshirave të veta, sepse Allahu është më i madh se çdo gjë që ekziston në këtë botë.

Esh'hedu el-la ilahe il-lAllah

Esh'hedu el-la ilahe il-lAllah

Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut!

Ky është shehadeti i (dëshmia e) parë, kuptimi i së cilës është: Të pohojmë se Allahu është Krijuesi i çdo gjëje si dhe Zoti, Sunduesi dhe Ai që përkujdeset për çdo gjë; dhe se vetëm Ai duhet të adhurohet i Vetëm pa asnjë ortak. Dhe se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut. Dhe se Ai është Një, pa ortak, s'ka fëmijë dhe askush nuk është i ngjashëm me Të. Andaj adhurimi nuk i kushtohet askujt tjetër veç Allahut dhe nuk i bëhet lutje askujt tjetër veç Tij.

Kjo dëshmi, se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, është dëshmia më e madhe në gjithësi dhe është themeli i besimit në të gjitha shpalljet hyjnore. Të gjithë profetët (paqja qoftë

mbi ta!), si Nuhu, Ibrahim, Musai dhe Isai, e deri te Muhamedi, (paqja qoftë mbi të!) i thirrën popujt e tyre në miratimin, pranimin dhe besimin se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut. Ajo është fjalë për hir të së cilës u krijuan të gjitha krijesat; për këtë fjalë Allahu i Lartësuar dërgoi të dërguarit dhe shpalli librat e Tij, dhe e bëri Xhenetin shpërblim për atë që e thotë atë me sinqeritet nga zemra.

Për hir të kësaj fjale do të ringjallen njerëzit prej varreve të tyre dhe do të japin llogari në Ditën e Kiametit; kush jetoj me të dhe e përmbylli me të jetën e tij, ka arritur fitoren më të madhe, e kush e refuzoi dhe nuk e shqiptoi atë, meriton përjetësinë në Zjarrin përvëlues.

Esh'hedu enne Muhammederr rresulullah

Esh'hedu enne Muhammederr rresulullah

Dëshmoj se Muhamedi është i dërguari i Allahut!

Kuptimi i kësaj dëshmie është që muslimani të dëshmojë se Allahu e ka dërguar Muhamedin si përmbyllës të shpalljeve hyjnore dhe si lajmëtar që ua kumton njerëzve mesazhin e Zotit të tyre; dhe të besojë prerazi se nuk ka rrugë për ta adhuruar Allahun dhe për të fituar kënaqësinë e Tij, veçse duke dëshmuar për Muhamedin se është i Dërguari i Allahut, duke e pasuar dhe duke e marrë atë për shembull (në fe), dhe duke e adhuruar Allahun sipas sheriatit që solli Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të!).

Kjo dëshmi përfshin gjithashtu faktin se i Dërguari i Allahut, Muhamedi (paqja qoftë mbi të!), erdhi thjesht për t'i rikthyer njerëzit në teuhid (monoteizëm), ashtu siç bënë para tij Ibrahim, Musai dhe Isai (paqja qoftë mbi ta!). Ai është i Dërguari i Zotit të botëve; ka ndjekur rrugën në të cilën kanë ecur të gjithë profetët në transmetimin dhe kumtimin e shpalljeve të Zotit të tyre, por pas tij nuk ka profet tjetër.

Hajje ales salah

Hajje ales salah

Eja në namaz!

Kuptimi i kësaj fraze është: O besimtarë, përkushtojuni adhurimit të Zotit tuaj; vërtet, Ai është Falës i madh dhe Mëshirëplot; pranon pendimin dhe i shlyen të këqijat.

Kjo është një thirrje dhe përkujtim për besimtarët se tashmë ka ardhur koha për të qëndruar para Zotit të tyre në namaz.

Hajje al-el felah

Hajje al-el felah

Eja në shpëtim!

Fjala "Felah" do të thotë: kënaqësi, fitore, siguri dhe shpëtim në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

Pjesë e domethënies së saj është dhe fitimi i kënaqësisë së Allahut, fitimi i Xhenetit dhe shpëtimi nga Xhehenemi; sepse kush beson dhe fal namaz, ka arritur të shpëtojë, e kush ka arritur të shpëtojë, ka fituar përjetësinë në Xhenet.

Allahu ekber, Allahu ekber

La ilahe il-lAllah

Përmbyllja e ezanit është me tekbir dhe teuhid.

Ezani përmbillet me përsëritjen e frazës "Allahu ekber" dhe me theksimin e frazës "La ilahe il-lAllah"; këto dy fraza janë theksuese të mesazheve të lartpërmendura, dhe mbi to mbështetet ekzistenca njerëzore. Kjo e vërtetë nuk ndryshon e as nuk shndërrohet, sado kohë e gjatë të kalojë dhe sado ngjarje të shumta të ndodhin; se Allahu është më i Madh se çdo gjë, se Allahu është i Adhuruari i vërtetë, se vetëm Ai është i denjë për adhurim dhe se adhurimi i çdo gjëje tjetër përveç Tij është i pavlefshëm.

Në përmbyllje: Ezani nuk është vetëm thirrje për namaz, por është thirrje për mbarësi, fitore dhe sukses; është një mesazh që jehon në xhami pesë herë në ditë, për të zgjuar zemrat dhe për të na kujtuar se Allahu është afër.

Hapja zemrën besimit dhe thuaj: "Dëshmoj se nuk ka të adhurar përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut", që të hysh në mëshirën e Allahut, të arrish lumturinë në këtë botë dhe të shpëtosh në botën tjetër, dhe të ringjallesh Ditën e Kiametit në mesin e besimtarëve.

Përmbajtja

SHPJEGIM I SHKURTËR I FJALËVE TË EZANIT.....	2
SHPJEGIMI I FJALËVE TË EZANIT.....	2

sq504v1.1 - 06/09/2026